



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
K R Y E S I A

Nr. 530 prot.

Tiranë, më 22.12.2017

Vendim nr. 24 datë 22.12.2017

**PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR VEPRAT DHE BOTIMIN MË TË  
MIRË SHKENCOR KUSHTUAR GJERGJ KASTRIOTIT - SKËNDERBEUT  
DHE EPOKËS SË TIJ**

*NË KUADRIN E VITIT 2018, SHPALLUR “VITI I SKËNDERBEUT”*

**Drejtuar :** - Asamblesë dhe akademikëve të ASH-së, seksioneve shkencore, sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës, sektorit të financës dhe sektorit të personelit;  
- Universiteteve, qendrave dhe institucioneve shkencore, shtëpive botuese, kërkuesve shkencorë të pavaruar.

Referuar nenit 4, pika f të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 “PËR AKADEMİNË E SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, ku thuhet se Akademia e Shkencave: f) organizon konkurse dhe dhënie çmimesh shkencore.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 493, datë 13.9.2017, *Për shpalljen e vitit 2018 “Viti mbarëkombëtar i Gjergj Kastriotit-Skënderbeut”*; si dhe nenit 5, pika 1, 2 të rregullores *Për themelin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre*, miratuar me urdhrin nr. 11, datë 6 tetor 2016 të Kryetarit të Akademisë së Shkencave; me propozim të seksionit të shkencave shoqërore e albanologjike në Akademinë e Shkencave, merret ky

**VENDIM:**

1. Shpalljen e konkursit për veprat dhe botimin më të mirë shkencor kushtuar figurës së Gjergj Kastriotit-Skënderbeut dhe epokës së tij; hero kombëtar i popullit shqiptar; protagonist i Rilindjes Europiane si më poshtë:

- Për veprën më të mirë shkencore dhe/ose dokumentare shkruar nga autorë shqiptarë.
- Për veprën më të mirë shkencore dhe/ose dokumentare shkruar nga autorë të huaj, shqip ose në gjuhë tjetër.
- Për veprën më të mirë shkencore dhe/ose dokumentare në vlerësimin e rrallësisë bukinistike. Përparësi kanë botimet diplomatike-anastatike të letërsisë humaniste shqip dhe/ose në gjuhë të huaj.

2. Pranohen për konkurrim studimet monografike dhe dokumentare të botuara prej vitit 2000 deri në vitin 2018. Të drejtën e propozimit e kanë institucionet akademike-universitare, botuesit dhe autorët vetë.

3. Për organizmin e këtij konkursi, pranë Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë ngrihet dhe funksionon një juri e specializuar, me studiues vendës e të huaj. Kjo juri ngarkohet që, në mënyrë autonome, të bëjë pranimin, përgjedhjen, nominimin dhe shpalljen fitues të tre kandidatëve pjesëmarrës në konkurs sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi. Juria ngrihet me vendim të Këshillit Ekzekutiv.

4. Pranimi i veprave konkuruese hapet më 1 janar 2018 dhe mbyllt më datën 30 qershor 2018. Nominimi i të përgjedhurve shpallet nga juria më 18 shtator 2018. Me secilin prej pjesëmarrësve në konkurs organizohet një ligjératë akademike e hapur për paraqitjen e rezultateve të punës së tyre kërkimore.

5. Për secilin prej fituesve do të ndahet diploma dhe një shpërbirim financiar. Çmimi special për veprat fituese shpallet publikisht në muajin nëntor 2018, që përmbyll Vitin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, shpallur me VKM sipërcituar.

6. Ngarkohet Këshilli Ekzekutiv i Akademisë së Shkencave që, në bashkëpunim me dy sektionet shkencore dhe me sektorin e botimeve dhe bibliotekës shkencore të ASH-së, të organizojë punën për krijimin e kushteve për konkurrim transparent, si dhe për funksionimin e jurisë sipas *Rregullores së çmimeve shkencore kombëtare* sipërcituar.

7. Ngarkohet specialisti i komunikimeve shkencore, marrëdhëniet me jashtë dhe publikun për njoftimin e këtij vendimi.

8. Ngarkohet specialisti IT për publikimin e këtij vendimi.

9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **SEKRETAR SHKENCOR**

**Akademik Vasil S. TOLE**

